



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY GJILAN
FAKULTETI I EDUKIMIT
Adresa: Rr. Zija Shemsiu, p.n., 60000 Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel. +381 (0) 280390112

Prof. dr. Bajram Kosumi
Rektor

SHTATË ETAPA TE PAVARËSISË SË KOSOVËS
Një pamje dhe përvojë personale për historinë e Kosovës në shekullin XX

Pavarësia e Kosovës mund të strukturohet në shtatë etapa. Këto etapa nuk do t'i ndajmë me vite, por me ngjarje dhe me personalitete kyçe të atyre ngjarjeve.

Këto etapa janë:

1. Hasan Prishtina dhe fillimi i luftës politike e luftarake për çlirimin e territoreve shqiptare të okupuara nga Serbia/Jugosllavia;
2. Veprimi i fshehte politik, i quajtur "ilegalja e Kosovës" (Adem Demaçi, Metush Krasniqi etj);
3. Revolucioni i Vitit 1981;
4. Formimi dhe aktiviteti i partive politike në vitet '90 (LDK , PPK etj);
5. Formimi i UÇK dhe lufta çlirimtare;
6. Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë/ Bombardimi i Serbisë/ UNMIK;
7. Shpallja e pavarësisë së Kosovës: 17 shkurt 2008.

Duke shpjeguar secilën nga këto etapa, mund të krijohet një pasqyrë e qartë e këtij procesi.

1. Hasan Prishtina dhe fillimi i luftës politike e luftarake për çlirimin e territoreve shqiptare të okupuara nga Serbia/Jugosllavia

Hasan Prishtina është politikani i fundit shqiptar që foli në emër të kombit. Në kryengritjen e vitit 1911 ai mori telegrame nga te gjitha hapësirat shqiptare, të cilët ia jepnin legjitimitetin të fliste në emër të tyre.

Ndodhi viti 1912, thyerja e Perandorisë Osmane, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, pushtimi nga shtetet fqinje të më shumë se gjysmës së territorit shqiptar, Luftërat Ballkanike dhe LPB.

Mbas LPB fillon konsolidimi i shtetit shqiptar, ndërsa Hasan Prishtinë nis një histori të re: luftën për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Serbia. Ai e dizajnoi këtë luftë, bashkë me shumë të tjerë, duke themeluar Komitetin "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", më 1 maj 1918. Me këtë komitet dhe programin e tij nis një luftë e re për çlirimin e territoreve shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë.

Kjo politikë e Komitetit e ka pasur edhe një segment ushtarak: çetat e kaçakëve shqiptar, më e njohura prej tyre Çeta e Azem Galicës.

2. Veprimi i fshehte politik, i quajtur "ilegalja e Kosovës" (Adem Demaçi, Metush Krasniqi etj)

LDB e vuri në plan të dytë projektin për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Partia Komuniste Jugosllave bëri një manovër të suksesshme për këtë punë: deri sa në një rën anë në Konferencën e Bujanit u vendos nga komunistët shqiptarë e serbë që pas LDB Kosova dhe viset e tjera shqiptare t'i bashkohen

Shqipërisë, në anën tjetër kreu i PKJ e shpalli të papranueshëm një epilog të tillë. Shteti komunist Jugosllav krijoi disa liri për Kosovën, por gjithmonë fati i shqiptarëve mbeti në mëshirën e Beogradit. Në këto kushte lëvizja patriotike në Kosovë fillon përshtatjen me taktika të reja: formohen grupe, organizata dhe parti të fshehta revolucionare. Ideatorë të këtij procesi qenë Adem Demaci dhe Metush Krasniqi. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve, dhjetëra mijëra patriotë revolucionarë, deri në vitin 1990, u ndoqën nga Kosova, u torturuan, u arrestuan, u vranë, u burgosën dhe mbajtën deri në njëzetetë vjet burg, si Adem Demaci.

Këto burgosje, ndjekje dhe vrasje nuk e shuan flakën e lirisë, përkundrazi, e ndezën më shumë. Për dyzet vjet me radhë këta revolucionarë e mbajtën të ndezur flakën e lirisë.

Unë e kam shumë të freskët dënimin e tretë të Adem Demacit me 18 shokë të tij, në vitin 1975. Nga viti i dytë në gjimnazit, ende e ruaj të freskët një faqe të revistës *Zëri*, në të cilën jepeshin emrat e dënimit të "armiqtë të shtetit", shkruar nga Ali Olloni Ende e ruaj të freskët komentimin e RTP, shkruar dhe lexuar nga poeti kosovar Fahredin Gunga, ku mallkoheshin "armiqtë e shtetit". Atëherë nuk e njihja asnjërin prej atyre emrave, përveç Adem Demacit. Sot, disa nga ata emra janë heronj të Kosovës, si Rexhep Mala e Isa Kastrati; disa janë persona me ndikim të madh në luftën për liri, si Skender Kastrati, Osman Dumoshi, Ilmi Ramadani etj.

3. Revolucionin e vitit 1981;

"Ilegalja e Kosovës" i dha frutat e vet në demonstratat e vitit 1968, po veçanërisht me Lëvizjen Studentore dhe Revolucionin e vitit 1981.

Pse 1981?

- Sepse në vitin 1981 u rihap "Çështja e Kosovës".
- Në Kosovë iu dha fund politikës komuniste Jugosllave, edhe pse ajo do të mbijetoje edhe për një dekadë. Aty u nda rruga e Kosovës nga Jugosllavia.
- Sepse në vitin 1981, si e kanë thënë edhe shumë historianë e publicistë, fillon shpërbërja e Jugosllavisë.
- Sepse në vitin 1981 fillon krijimi i një mendimi të ri politik dhe të një klase të re politike, e cila do të ketë rol vendimtar deri në çlirimin e Kosovës.
- Sepse me demonstratat e vitit 1981 u krijua një kualitet i ri i lëvizjes kombëtare, pa shpërbërjet e mëparshme, duke shpërthyer rrethin e grupeve ilegale dhe duke e bërë parullën Kosova Republikë parullë gjithë-popullore.
- Sepse në vitin 1981 në Kosovë, bashkë me Lëvizjen e Solidarnostit në Poloni, fillon rënia e perandorisë komuniste të dirigjuar nga Rusia.

Revolucioni i vitit 1981 e ndërgjegjësoi Kosovën dhe gjithë popullin shqiptar në Jugosllavi për procesin e shkatërrimit të Jugosllavisë dhe për domosdonë e gjetjes së një rruge shpëtimi për Kosovën dhe shqiptarët.

Unë e kujtoj vitin 1981 në shumë përmasa. Besoj se aty liria e ka dehur popullin shqiptar. Metë drejtë Rexhep Qosja e quan vitin 1981 "Rilindje të dytë shqiptare".

Dua t'ua tregoj njërin prej këtyre përmasave.

Në vitin 1982, pas dënimit në Gjykatën e Prishtinës, më dërguan, me disa dhjetëra shokë të evolucionit, në Burgun Qendror në Beograd. Aty filluan hetimet e dyta. Mua më merrte në pyetje një hetues i vjetër federal, i cili interesohej vetëm për një çështje: cila është qendra e "kundërrevolucionit"?

Një ditë i thashë: ne nuk duam ta shkatërrojmë Jugosllavinë. Ne duam republikën tonë. Nëse doni ta ruani Jugosllavinë, pranojeni republikën e Kosovës, përndryshe Jugosllavia do të shkatërrohet.

Ai, duke besuar në çiltërsinë time, më tha tërësisht nga shpirti: Bajram, Nuk ekziston më Jugosllavia! E shkatërruat në Kosovë!

4. Formimi i partive politike shqiptare në vitet nëntëdhjetë

Formimi i LDK në vitin 1989, sado me kontroversa të shprehura më vonë, ka qenë ngjarje madhore për Kosovën, së pakut për dy arsye:

- për herë të parë populli shqiptar i Kosovës u rreshtua kundër Serbisë në tërësi;
- bashkësia ndërkombëtare fillon ta trajtojë çështjen e Kosovës si një problem që do zgjidhje.

Kjo është periudha e nëpërkëmbjes më të madhe të shqiptarëve në kohën e re. Partitë politike vepronin në disa zyra të vogla skutave të Prishtinës, aktivistët ndiqeshin e rriheshin kudo, shkollat mbanin mësim në garazhe e bodrume, ndërsa sapo binte terri i parë shqiptari mbyllej në shtëpi duke pritur rrezikun. Rreziku shfaqej edhe në formën e një polici të vetëm serb, i cili nëpërkëmbte një lagje të tërë.

Krahas LDK u formuan edhe parti më revolucionare, si Partia Parlamentare e Kosovës dhe UNIKOMB, të cilat më vonë do të përshpejtojnë procesin e rezistencës aktive dhe do të përgatisin popullin të rreshtohet në krah të luftës së UÇK. Nga viti 1996 PPK angazhohet për rezistencën aktive, ndërsa nga viti 1997 e përkrahu dhe e mbrojti publikisht e në takimet diplomatike luftën e UÇK.

Kjo politikë e rezistencës aktive kulmoi me protestat dhe demonstratat e nisura nga studentet e Universitetit të Prishtinës në vitin 1997. Këto demonstrata në verën e vitit 1998 u shndërruan në përkrahje masive gjithë-popullore për UÇK. Dhjetëra mijëra qytetarë brohoritnin në sheshet e Prishtinës: “UÇK jemi ne!” Ky legjitimitet popullor ndaj UÇK-së e pamundësoi që qendrat e vendosjes ndërkombëtare ta trajtojnë ndryshe UÇK, përveç si një ushtri çlirimtare.

Më kujtohet një takim me ambasadorin e atëhershëm të Gjermanisë në Beograd, z. Wilfried Grueber. Në takim unë e mbroja të drejtën e shqiptarëve dhe të UÇK për të luftuar për lirinë edhe me armë dhe se NATO duhej të ndërhyjë për të parandaluar gjenocidin e Serbisë mbi popullin shqiptar. Mbas takimit, deri sa e përcillja ambasadorin shkallëve nga kati i dytë, ai më tha “privatisht” me zë të ulët: ju lutem, me luftën e armatosur po e shkatërroni ekzistencën e popullit shqiptar në Kosovë. NATO nuk do ta shkrep asnjë plumb kundër Serbisë për Kosovën.

Iku ambasadori, më vonë kam lexuar që ai nuk ka pasur një karrierë të mirë diplomatike.

5. Formimi i UÇK dhe lufta çlirimtare

Lufta e UÇK pa dyshim është historia më e dhimbshme dhe më krenare në rrugën e Kosovës për liri. Por në gjithë këtë histori, dy janë momentet kyçe.

1. Momenti I parë është rënia heroike e Adem Jasharit dhe e 54 anëtarëve të Familjes Jashari. Flijimi I Familjes Jashari e ndërroi rrjedhën e historisë së Kosovës. Pse?

- Sepse ky flijim e mbylli çdo rrugë për kthim prapa: shqiptarët nuk kishin ku të kthehen në asnjë farë lloj Serbie. Ata ose duhej të luftonin për liri, ose do të therorizoheshin të gjithë.
- Sepse ky flijim i bindi edhe qendrat e vendosjes ndërkombëtare se në Kosovë ose duhej gjetur një zgjidhje ose do të zhvillohej një luftë shkatërrimtare deri te shqiptari I fundit.
- Sepse ky flijim e bindi edhe Serbinë se në Kosovë ose do të vriste pandërprerë të gjithë ose do të duhej të lëshonte pe.

2. Momenti I dytë është dëbimi dhe kthimi i shqiptarëve në Kosovë.

Më kujtohet si e kam përjetuar këtë çështje në malet e Marecit dhe në Majac bashkë me UÇK. Kur arriti shifra e të dëbuarve në 700.000 persona, më kapi një frikë e thellë! Kujt i duhej Kosova pa njerëz? Në mbrëmje dëgjova premtimin e Tony Blerit: të gjithë refugjatët do të kthehen shumë shpejt në shtëpitë e tyre!

Me hyrjen e NATO dhe UNMIK në Kosovë, jo të gjitha qendrat e vendosjes kanë pasur një vizion për lirinë e Kosovës. Kthimi i të gjithë refugjatëve për një kohë shumë të shkurtër, e vulosi për herë të fundit se Kosova është e atyre që jetojnë aty dhe jo log i ushtrive gjakatare.

6. Konferenca Ndërkombëtare e Rambujesë/ Bombardimi i Serbisë/ UNMIK;

Si rezultat I luftës së shqiptarëve për lirinë e Kosovës, qendrat e vendosjes ndërkombëtare ndërhyjnë për të gjetur një zgjidhje për Kosovën, duke organizuar Konferencën e Rambujesë. Marrëveshjen e Rambujesë e nënshkroi në Paris Delegacioni I Kosovës, në mars të vitit 1999, ndërsa Serbia nuk e nënshkroi dhe ky fakt solli bombardimin e NATO-s mbi caqet ushtarake serbe dhe miratimin në KS të OKB të Rezolutës 1244, me të cilën legjitimohet misioni qeverisës i OKB në Kosovë, UNMIK.

UNMIK, sa do me politika të paqarta për të ardhmen e Kosovës, ka shërbyer mjaft mirë për ta përgatitur Kosovën për funksionim si shtet.

Nga Rambuje dua t'ua tregoj vetëm një situatë: Delegacioni i Kosovës punonte tërë kohën e flinte shumë pak. Edhe pas seancave zyrtare të Konferencës ne rrinim për orë të tëra duke diskutuar se si do t'ia bëjmë. Hanim ushqimet shpejt e shpejt dhe uleshim në ndonjë zyre a dhomë për të vazhduar diskutimet si t'ia bëjmë? Ndodhte të zgjoheshim para orës 6 të mëngjesit për t'u përgatitur për seancën e orës 8.

Ndërsa Delegacioni i Serbisë, i udhëhequr nga presidenti serb Millan Millutinoviç, hante, pinte dhe këndonte. Ata këndonin edhe natën, me verërat më të shtrenjta të Kështjellës së Rambujesë.

7. Shpallja e Kosovës shtet i Pavarur: 17 shkurt 2008.

Në vitin 2005 KS I OKB e dërgoi ambasadorin Kai Eide për të vlerësuar kushtet për gjetjen e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën. Në tetor 2005 Ambasadori Eide dorëzoi raportin në KS, në të cilin vërtetonte se Kosova është përgatitur për të ecur drejt zgjidhjes përfundimtare. KS I OKB emëroi ambasadorin Marti Ahtisari për të propozuar një zgjidhje. Në shkurt të vitit 2007 ambasadori Ahtisari propozoi formimin e shtetit të Kosovës.

Më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës, në pajtim me qendrat e vendosjes ndërkombëtare përëndimore, shpalli Republikën e Kosovës, si shtet të pavarur e sovran.

Unë shkova që herët në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës. Binte borë e madhe. Bashkë me disa deputetë u ulëm pranë dritareve të një zyre dhe shikonim makinat e zyrave të huaja që vinin si mysafirë dhe vëzhgues në seancën e shpalljes së pavarësisë. Për herë të parë ata kishin vendosur në makina flamujt e shteteve të tyre. Me këtë veprim, ata na tregonin se kishin filluar ta konsideronin Kosovën shtet edhe para se të shpallej.

Përmbyllje

Të dashur të pranishëm,

Sot jemi këtu, në trembëdhjetë vjetorin e Pavarësisë, njëzet e një vjet pas përfundimit të luftës, falë gjakut, dijes dhe djersës së qindra mijëra burrave e grave që u sakrifikuan për lirinë e Kosovës.

Sot ne jemi të nderuar që e vazhdojmë punën e tyre.

Sot, Hasan Prishtinë, Adem Jashar e Xhevë Lladrovci është:

- mësuesi, profesori dhe studenti që e ngritin cilësinë e shkollës fillore, të mesme dhe universitetit;
- mjeku i përkushtuar për shëndetin e pacientit;
- gjykatësi dhe prokurori i ndershëm, gardian i paqes e i drejtësisë;
- biznesmeni që punëson shumë punëtorë dhe prodhon të mira materiale;
- inxhinieri i IT që e hap perspektivën e Kosovës në botën virtuale;
- kryetari i komunës që mban përgjegjësi maksimale para qytetarëve;
- politikani i pakorruptuar;
- polici dhe ushtari që e kalojnë natën duke u kujdesur për paqen tonë;
- e reja dhe i riu që e duan Kosovën, edhe atëherë kur ajo nuk i ofron të gjitha ato që ata ëndërrojnë.

Dua ta përmbyll këtë fjalë me një thënie shumë të njohur, po e cila më bën të kthjellem sa herë më mjegullohet mendja: mos pyet çka bën atdheu për ty, po çka bën ti për atdheun!

Ju faleminderit dhe na priftë e mbara gjithmonë!

Gjilan, më 16 shkurt 2021